



“Raporti monitorues i zbatimit të Planit Buxhetor për Rininë në Bashkinë Durrës”

Qershor 2020





Autor:

Observatori për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinjve



© Aplikimet për leje për të shumëfishuar ose përkthyer pjesë nga ky publikim duhet të dërgohen në:

Observatori për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinjve
Rruga "Brigada e VIII", Pall. LID, K.1, Z.1, Tiranë, Shqipëri
Email: info@observator.org.al
Webmail: www.observator.org.al

Ky publikim është realizuar nga UNFPA me ekspertizën e Observatorit për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinjve (Observatori), në kuadër të projektit "Leave No One Behind" ("Askush të mos Mbetet Pas"), një Program i përbashkët i OKB-së i financuar nga Swiss Agency for Development and Cooperation (SDC) dhe zbatuar nga katër agjensi të OKB: UNDP, UNFPA, UNICEF, dhe UN WOMEN në partneritet me Qeverinë Shqiptare. Ky projekt synon fuqizimin e personave vulnerabël në Shqipëri që të kenë akses të barabartë në shërbimet dhe mundësitë publike, të kenë një zë në vendimmarrjen publike, që ndikon në jetën e tyre dhe t'i kërkojnë llogari zyrtarëve publikë, duke i mbajtur përgjegjës për dështimet apo arritjet.

Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e Observatorit, në emër të Rrjetit të Organizatave "Zëri i të Rinjve". Opinionet e shprehura këtu janë të autorit dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht opinionet e UNFPA-së, UN Albania apo SDC.

DY FJALË NË VEND TË HYRJES

“Sa më shumë e rrisim pjesëmarrjen aktive dhe partneritetin me të rinjtë, aq më mirë u shërbejmë atyre. ... Dhe sa më gjithëpërfshirëse të jetë puna me ta si partnerë në shërbime, aq më shumë e rritim vlerën tonë publike për të gjithë komunitetin.” - Carmen Martinez

Vendimmarrësit duhet të njohin dhe vlerësojnë që angazhimi i të rinjve në shoqëri shërben si një mjet i rëndësishëm për zhvillimet demokratike. Ndarjet social-ekonomike të shoqërisë sonë, përjashtimi social, papunësia, pamundësia për edukim profesional dhe varfëria, po prekin gjithnjë e më shumë njerëz, dhe veçanërisht të rinjtë. Ndaj është shumë e rëndësishme të nxisim dhe zhvillojmë angazhimin qytetar dhe shoqëror të të rinjve që nga niveli vendor (lokal) deri në atë kombëtar e më gjerë.

Tashmë Shqipëria ofron një panoramë optimiste ligjore në lidhje me kornizimin për garantimin dhe zbatimin e të drejtave të të rinjve në vend. Ligji nr. 75/ 2019 “Për Rininë” u miratua në Nëntor të 2019, duke bërë të mundur integrimin dhe bashkërendimin e shumë dokumenteve ligjore dhe politik të hartuar më parë, siç janë: Ligji për Vetëqeverisjen vendore, Ligji për Financat e Vetëqeverisjes Vendore, Plani Kombëtar I Veprimit për Rininë 2015-2020.

Të dhënat demografike tregojnë se të rinjtë (grupmosha 15-29 vjeç) përbën rreth 25% të popullsisë në vend. Ndërkohë, përsa i përket të dhënave në nivel lokal në Bashkinë Durrës për rininë, siç janë: demografia, buxhetet e realizuara, aktivitetet dhe bashkëpunimet, planet vendore dhe planet buxhetore, është realizuar dhe publikuar në vitin 2018 një analizë e situatës nga UNFPA me ekspertizën e Observatorit, në kuadër të projektit “Leave No One Behind” (“Askush të mos Mbetet Pas”).

Ky raport monitorimi është realizuar për të vlerësuar ecurinë e zbatimit të këtij plani buxhetor për rininë në nivel lokal, si dhe për të matur dhe vlerësuar qasjen e ligjit të ri për rininë të zbatuar në politikat vendore.

METODOLOGJIA E MBLEDHJES SË INFORMACIONIT PËR RAPORTIN MONITORUES

Ky raport monitorimi ka si qëllim monitorimin e ecurisë së zbatimit të planeve buxhetore për rininë në nivel vendor, duke vlerësuar zbatimin e Ligjit 75/2019 "Për Rininë" (miratuar në Nëntor 2019), si dhe shërbimet dhe programet për të rinjtë, konceptuar si funksion publik apo si shërbim i veçantë posaçërisht për të rinjtë ofruar nga qeverisja vendore.

Mbledhja e të dhënave për këtë monitorim është bazuar në 3 burime informacioni:

- **1. Formulari për mbledhjen e të dhënave nga Bashkia** – i cili është bazuar në formularin e parë duke ruajtur disa pyetje bazë, siç janë: të dhënat mbi numrin e të rinjve, shkollat, qendrat sociale, buxheti. Duke i'u referuar këtyre pyetjeve nisur dhe nga vlerësimi i parë, është krijuar panorama krahasimore e ndryshimit në kohë. Formulari është pasuruar më tej me pyetje të cilat evidentojnë se (i) deri në ç'masë janë zbatuar planet e parashikuara në dokumentin e parë; (ii) krijimi dhe zhvillimi i infrastrukturës rinore dhe të hapësirave rinore të sigurta (qendra rinore, qendra shumë-funksionale, etj); (iii) ngritja dhe funksionimi i Këshillit Vendor Rinor (KVR) duke analizuar: pengesa, nevoja, vështirësi, histori suksesi, etj; (iv) (nëse janë hartuar) standarte për ofrimin e veprimtarive rinore dhe punësimin e të rinjve; (v) nxitja e vullnetarizmit të të rinjve dhe edukimi joformal i tyre; (vi) mbledhja e të dhënave dhe raportimi mbi situatën e të drejtave të të rinjve; (vii) aplikimet e realizuara dhe të fituara nga Njësitë e Qeverisjes Vendore (NJQV) me fokus ose përfshirë tematikën rinore; (viii) marrëveshjet e realizuara me fokus ose përfshirë tematikën rinore; (ix) bashkëpunimet apo aktivitetet rinore të realizuara në bashkëpunim me institucione të tjera lokale, qendrore apo ndërkombëtare; (x) aktivitete informuese mbi Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm/ Sustainable Development Goals (OZHQ/SDGs).
- **2. Pyetësor me të rinjtë** – Nisur dhe nga pyetësori i parë i përdorur për hartimin e Planit të Buxhetimit për Rininë, ky pyetësor është bazuar në: (i) programet që Bashkia ka për të rinjtë, (ii) marrjen e njoftimeve dhe informacioneve, (iii) vlefshmërinë dhe dobishmërinë e këtyre aktiviteteve dhe informacioneve nga ana e të rinjve, (iv) nevojat që të rinjtë kanë, si dhe marrëdhëniet që vetë të rinjtë kanë me njëri tjetrin; (v) nxitjen e vullnetarizmit të të rinjve dhe edukimin joformal të tyre; (vi) bashkëpunime apo aktivitete rinore të realizuara në bashkëpunim me institucione të tjera lokale, qendrore apo ndërkombëtare; (vii) Aktivitete informuese mbi OZHQ.
- **3. Fokus grup me të rinjtë** që janë pjesë e KVR dhe/ ose të rinj që kanë përfittuar nga veprimtaritë e Qendrave shumë-funksionale apo qendrave rinore, - kjo nisur nga fakti që mund të ketë Bashki që nuk i kanë krijuar ende KVR dhe/ ose mund të jenë të jenë ngritura së fundmi dhe nuk kanë shumë informacion për të ofruar. Në këto fokus grupe është vjelur informacion mbi: (i) rolin e tyre si ndërmjetës midis grupeve rinore të ndryshme (në bazë etnike, grupmoshe, arsimit, formimit, vendbanimi/ lagje, etj) dhe Bashkisë, (ii) evidentimi i pikave të forta dhe të dobëta të KVR, (iii) hapat e mundshme për përmirësimin e funksionimit të tyre.

SITUATA NË BASHKINË DURRËS

1. INFORMACION I PËRGJITHSHËM



Numri i të rinjve 15-29 vjeç

Në Bashkinë Durrës janë 13,220 të reja/rinj¹



Numri i institucioneve arsimore

Në Bashkinë Durrës ka 13 shkolla të mesme dhe 1 universitet²



Numri i qendrave komunitare

Në Bashkinë Durrës ka 1 qendër shumë-funksionale (Qendra shumë-funksionale e Nishtullës) dhe 1 qendër rinore (Qendra Rinore "Udhëtimi i Lirë")³

- 49% e të rinjve të anketuar pohojnë se janë në dijeni të ngritjes së Qendrës Rinore/ Shumë-funksionale.⁴
- 53% e të rinjve të anketuar mendojnë se ngritja/ funksionimi i tyre ka ndikuar në përmirësimin e jetës social-kulturore së të rinjve.⁵



Numri i organizatave rinore/që kanë në fokus të rinjtë

Në territorin e Bashkisë Bashkisë Durrës aktualisht janë të angazhuara:

- 7 organizata lokale
- 5 organizata kombëtare
- 6 organizata ndërkombëtare⁶

65% e të rinjve të anketuar njohin organizata të ndryshme me fokus të rinjtë që operojnë në territorin e Bashkisë Durrës. 69% e tyre e konsiderojnë punën e tyre disi / shumë të vlefshme.⁷

2. STRATEGJITË/POLITIKAT/AKTIVITETET E BASHKISË NË LIDHJE ME TË RINJTË

Bashkia Durrës ka në përbërje një drejtori të veçantë që përfshin çështjet e rinisë: Drejtoria e Arsim-Kulturë-Sport-Rini-Komunitete Fetare, në të cilin ka dhe një punonjës të dedikuar për rininë.⁸

¹Burimi: Bashkia Durrës, Maj - Qershor 2020

²Ibid

³Ibid

⁴Burimi: Pyetësor me të rinjtë, Maj - Qershor 2020

⁵Ibid

⁶Burimi: Bashkia Durrës, Maj - Qershor 2020

⁷Burimi: Pyetësor me të rinjtë, Maj - Qershor 2020

⁸Burimi: Bashkia Durrës, Maj - Qershor 2020

- Në vitin 2015 është ngritur në Bashkinë Durrës dhe Komisioni i Shëndetësisë, i cili shërben si një njësi e dedikuar për shëndetin publik.⁹
- Në Bashkinë Durrës ka një Strategji Zhvillimi për Territorin, e cila mbulon periudhën kohore 2015-2030. Strategjia përfshin angazhimin e rinisë duke synuar të nxisë bashkëpunimin ndërmjet organizatave rinore për të fuqizuar politikën dhe programet rinore si dhe për përfshirjen e tyre në aktivitete apo projekte të ndryshme kulturore, artistike dhe sociale. Ekziston gjithashtu një Plan Veprimi për Integrimin e Komunitetit Rom dhe Egjiptian si dhe Plani i Veprimit për Barazinë Gjinore në nivel vendor midis burrave dhe grave, ndërmjet vajzave dhe djemve si dhe midis të rejave dhe të rinjve miratuar më vitin 2018.¹⁰

31% e të rinjve të anketuar janë në dijeni të programeve /prioriteteve të Bashkisë në lidhje me të rinjtë.¹¹ Të rinjtë gjithashtu njohin dhe ligjet/programet/prioritetet kombëtare apo ndërkombëtare që lidhen me rininë. "...Jemi në dijeni të Ligjit për Rininë sepse jemi përfshirë në Qershor-Nëntor 2018 në hartimin e tij. Kemi dhënë komente/sugjerime nëpërmjet fokus grupeve në Durrës."¹²

- Që nga vitit 2019 janë realizuar disa programe për rininë që përfshijnë:
 - a) vizita në familje
 - b) identifikim/ referim rastesh në nevojë pranë zyrës pritëse
 - c) manaxhim i rasteve në nevojë për mbrojtje dhe riintegrim
 - d) mbështetje pas shkollorë për nxënës të gjimnazit
 - e) shërbim biblioteke
 - f) kurs anglishteje për të rinj
 - g) këshillim psiko-social individual dhe në grup (sipas nevojave)
 - h) aktivitete psiko-sociale tematike me të rinj
 - i) klasa prindërimi
 - j) aktivitete aftësimi për jetën me të rinj
 - k) kamp veror
 - l) trajnim vullnetarësh/ praktikantësh të Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës, Zyrës Rajonale të Punësimit dhe komunitetit
 - m) trajnim të të rinjve gjimnazistë për metodologjinë "Ti krijon"
 - n) realizim nismash rinore
 - o) shpërndarje e kiteve me ndihma (në ushqime, higjienë, çanta/ materiale shkollorë)
 - p) referuar/ punësuar në biznese
 - q) referuar dhe regjistruar në kurse formimi profesional
 - r) aktivitete artistike e kulturore
 - s) udhëtime në pika turistike etj.

Disa nga çështjet kyesore që Bashkia ka pasur prioritet gjatë vitit 2019 përfshijnë:

 - a. Përfshirja gjithnjë e më shumë e rinisë në jetën sociale dhe vendimmarrëse.
 - b. Hartimi i politikave për punësimin e të rinjve.
 - c. Përmirësimi i ambientit. Nisma për pastrimin e ambienteve të përbashkëta në zonat banuara.¹³

⁹Ibid

¹⁰Ibid

¹¹Burimi: Pyetësor me të rinjtë, Maj - Qershor 2020

¹²Burimi: Fokus grup me Këshillin Rinor, Maj - Qershor 2020


¹³Burimi: Bashkia Durrës, Maj - Qershor 2020

Pjesë e aktiviteteve ku është angazhuar Bashkia, kanë qenë dhe aktivitete për nxitje të vullnetarizmit të të rinjve dhe edukimit joformal të tyre nëpërmjet trajnimit të vullnetarëve / praktikantëve dhe angazhimit të tyre në aktivitete.

Vetë të rinjtë listojnë si aktivitete ku kanë marrë pjesë aktivitetet e realizuara në bashkëpunim me organizatat.¹⁴

“Kinfolk Coffee library Durrës është biznes social që ka në fokus aktivizimin e të rinjve. Ofrojnë hapësira për organizim dhe kurse gjuhësh të huaja e profesionale.”¹⁵

Grafiku 1: Përqindja e të rinjve që kanë informacion për:¹⁶



3. ANGAZHIMI I TË RINJVE NË VENDIMARRJE

- Që nga vitit 2013 në Bashkinë Durrës është ngritur YAC (Youth Advisory Council) i cili funksionon si një grup këshillues i të rinjve. Anëtarët e tij pranohen në baza vullnetare nëpërmjet një formulari aplikimi. Pjesë e tij janë dhe të reja/ rinj nga njësitë administrative të Bashkisë Durrës. Sugjerimet e këtij këshilli dërgohen në bashki.¹⁷

59% e të rinjve të anketuar janë në dijeni të ekzistencës së Këshillit Rinor.

49% e tyre e konsiderojnë disi/ shumë të vlefshëm rolin e tij në përcaktimin e prioriteteve të rinisë.¹⁸

- Përsa i përket pjesëmarrjes së të rejave/ rinjve në proceset dhe vendimmarrjet demokratike, gjatë mbledhjeve të Këshillit Bashkiak për miratimin e buxhetit të Bashkisë Durrës asiston dhe ky grup të rinjsh, të cilët diskutojnë dhe japin mendimin e tyre. Gjithashtu gjatë hartimit të Planit të Veprimit për Integrimin e Komunitetit Rom dhe Egjiptian janë përfshirë të rinjtë e këtyre komuniteteve.

¹⁴Ibid

¹⁵Burimi: Fokus grup me Këshillin Rinor, Maj - Qershor 2020

¹⁶Burimi: Pyetësor me të rinjtë, Maj - Qershor 2020


¹⁷Burimi: Bashkia Durrës, Maj - Qershor 2020

¹⁸Burimi: Pyetësor me të rinjtë, Maj - Qershor 2020

Vetë të rinjtë mendojnë se angazhimi i tyre nga bashkia është i pamjaftueshëm dhe kryesisht realizohet nëpërmjet organizatave që veprojnë në zonë:

“...Informacionet për strategjitë apo ligjin për rininë i kemi marrë nëpërmjet aktivizimit në organizatat e shoqërisë civile”²⁰

Grafiku 2: Përqindja e të rinjve që kanë marrë pjesë në takime që Bashkia ka zhvilluar me të rinjtë për përcaktimin e prioriteteve të zhvillimit të zonës²¹



- Disa nisma janë ndërmarrë për angazhimin e të rejave/ rinjve në proceset dhe vendimmarrjet demokratike duke përfshirë: trajnime për buxhetimin me pjesëmarrje të grave, kurse aftësimi për jetën, përfshirje në grupe komunitare si dhe prioritizim nevojash.²²
- Për nxitjen e punësimit të të rejave/ rinjve janë ndërmarrë disa nisma që përfshijnë: aftësimin e tyre nëpërmjet kurseve të anglishtes, kurse aftësimi për gjenerim të ardhurash, trajnime për etikën e punës me fëmijët, ofrimin e praktikave të punës si dhe mentorim/ ndjekje gjatë praktikës, organizimin e panareve të shërbimeve, si dhe mbështetje me fond për hapje biznesi.²³

Vetë të rinjtë identifikojnë nevojën e ndërmarrjes së më shumë nismave nga Bashkia për të nxitur punësimin e të rinjve:

8% e të rinjve konsiderojnë si prioritet nga Bashkia ofrimin e mundësive të punësimit dhe 25% e tyre ofrimin e trajnimeve/ formimit profesional për të rinjtë.²⁴

¹⁹Burimi: Bashkia Durrës, Maj - Qershor 2020

²⁰Burimi: Fokus grup me Këshillin Rinor, Maj - Qershor 2020

²¹Burimi: Pyetësor me të rinjtë, Maj - Qershor 2020

²²Burimi: Bashkia Durrës, Maj - Qershor 2020

²³Ibid

²⁴Burimi: Pyetësor me të rinjtë, Maj - Qershor 2020

- Gjatë kësaj periudhe janë ndërmarrë gjithashtu disa aktivitete për të nxitur përfshirjen e të rinjve në çështjet mjedisore dhe turistike që përfshijnë: udhëtime/ ekskursione, pastrime në komunitet si dhe seanca informuese mbi këtë temë.²⁵
- Mjaft aktivitete janë realizuar dhe në fushën artistike dhe kulturore duke përfshirë aktivitete për promovimin e punëve të të rinjve të realizuara në kuadër të nismave rinore, 15 aktivitete të realizuara në Qendrën Rinore të Nishtullës si dhe aktivitete në kuadër të ditëve ndërkombëtare.²⁶
- Një sërë nismash janë ndërmarrë dhe për përfshirjen e të rejave/ rinjve në aktivitete edukuese shëndetësore duke përfshirë trajnime, aktivitete aftësimi për jetën, aktivitete psiko-sociale, klasa prindërore, këshillim, paketa ndihmesh si dhe organizimin e një panairi shërbimesh.²⁷

4. BUXHETI MBI RININË²⁸

Viti	Kategoria	Buxheti i planifikuar (LEKË)	Buxheti i realizuar (LEKË)
2015	Shërbimet Sociale	13,000,000	13,000,000
	Arsimi dhe Sportet	20,629,000	20,629,000
2016	Shërbimet Sociale	13,500,000	13,500,000
2017	Shërbimet Sociale	14,300,000	14,300,000
	Shërbimet Sociale	22,461,720	
2018	Arsimi dhe Sportet	91,000,000	
	Arsimi	2,000,000	2,000,000
2020	Arsimi	2,000,000	2,000,000

**Shpenzimet në fushën e Arsimit për vitin 2019 dhe 2020 i dedikohen të rinjve të dalluar të qytetit të Durrësit, ekselentëve në maturën shtetërore si dhe fituesve të olimpiadave kombëtare në lëndët shoqërore dhe shkencore. Për vitin 2019 janë përfitues 39 të rinj.*

5. KOMUNIKIMI NË LIDHJE ME ÇËSHTJET E RINISË

- Për të bërë njoftime dhe komunikime të ndryshme, Bashkia Durrës ka një website zyrtar: www.durres.gov.al. Gjithashtu Bashkia publikon njoftime në facebook të Bashkisë si dhe në Facebook të Qendrës së Nishtullës.²⁹

²⁵Burimi: Bashkia Durrës, Maj - Qershor 2020


²⁶Ibid

²⁷Ibid


²⁸Ibid

²⁹Burimi: Bashkia Durrës, Maj - Qershor 2020

Grafiku 3: Përqindja e të rinjve që listojnë kanalet e mëposhtme si burime informacioni³⁰



Grafiku 4: Përqindja e të rinjve që deklarojnë se diskutojnë/ prezantojnë/ bëjnë me dije shqetësimet/ nevojat dhe kërkesat e tyre në burimet më poshtë³¹



³⁰Burimi: Pyetësor me të rinjtë, Maj - Qershor 2020

³¹Ibid

- Të dhëna/ informacione periodike për dhe mbi të rinjtë mbahen në Qendrën Komunitare Nishtulla mbi përfituesit në këtë qendër.³²
- Bashkia Durrës ka realizuar një anketim në bashkëpunim me Observatorin mbi nevojat apo prioritetet e të rinjve.³³
- Për të adresuar më mirë çështjet që lidhen me rininë, Bashkinë do ta ndihmonte:
 - Ofrimi i një ndihme me ekspertizë për hartim studimesh/ analizim të dhënash;
 - Ofrimi i trajnimeve për stafin për të njohur më mirë legjislacionin dhe për të qenë sa më efektiv në punën me të rinjtë;
 - Fonde në dispozicion dhe të dedikuara për të mbështetur nismat rinore që synojnë të sjellin ndryshime konkrete në komunitet;
 - Mbështetja për organizimin e aktiviteteve në kuadër të ditëve ndërkombëtare;
 - Mbështetja financiare për Qendrën Komunitare Multifunksionale Nishtulla për: blerje të programit të përpunimit të të dhënave (SPSS), blerje të 5 kompjuterave/ serverave për të mundësuar krijimin e një laboratorit informatike në shërbim të trajnimit dhe fuqizimit të komunitetit, hapjen/ pilotimin e kurseve të artit (pikturë, kërcim, muzikë), përgatitjen e publikimeve me tematika të ndryshme duke përfshirë dhe një broshurë për shërbimet që ofron qendra, ndërtimin e një minikalçetoje pranë saj, krijimin e një mjedisi shtesë pranë qendrës për realizim aktivitetesh masive me komunitetin dhe rininë;
 - Instalimin e sistemit të kamerave për më shumë siguri në qendër;
 - Mbështetja e zyrës pritëse për shërbimin psiko-social më bazë materiale për ta bërë atë më miqësore me përfituesit;
 - Realizimi i kampeve verore me të rinj;
 - Mbështetja për hartimin e manualeve dhe guidave që do të ndihmonin në punën e përditshme të staftit të Bashkisë për fusha të ndryshme.³⁴

Ndërkohë, të rinjtë listojnë si nevojë nga Bashkia:

“Hartimin dhe ndjekjen me përpikmëri të një plani zhvillimi për rininë.”³⁵

³²Burimi: Bashkia Durrës, Maj - Qershor 2020

³³Ibid

³⁴Burimi: Bashkia Durrës, Maj - Qershor 2020

³⁵Burimi: Fokus grup me Këshillin Rinor, Maj - Qershor 2020

Hartëzimi i detyrimeve ligjore për Njësitë e Qeverisjes Vendore (NJQV) dhe aktivitetet e realizuara me fokus RININË, - Bashkia Durrës

Ligji për vetëqeverisjen vendore Kryesisht angazhime në parim	Nr	Përcaktimet ligjore për NJQV në lidhje me zhvillimin e politikave vendore rinore	Detyrimet / aktivitetet / tregues që rrjedhin për NJQV ³⁶	Angazhime të realizuara gjatë vitit 2018 – Bashkia Durrës ³⁷	Premtime në Plan buxhetin e Bashkisë viti 2019 – Bashkia Durrës ³⁸	Koment
	1	Realizimi i shërbimeve nga Qeverisja Vendore duhet të bëhet në forma të përshtatshme, bazuar në nevojat e antar/eve të bashkësisë, në përputhje me standardet e kërkuara me ligji apo akte të tjera normative, si dhe përmes nxitjes efektive të pjesëmarrjes gjithëpërfshirëse të bashkësisë në qeverisjen vendore. ³⁹	- NJQV zhvillon një plan strategji zhvillimi; ⁴⁰ - Planet e NJQV duhet të jenë në harmoni me ato kombëtare dhe rajonale. ⁴¹		- Krijimi i programit për nxitjen e punësimit të të rejave dhe të rinjve në Bashki. ⁴²	
	2	Funksionet e bashkisë në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike (kryesisht në mirëmbajtjen e institucioneve arsimore apo zhvillimin e aktiviteteve edukuese e promovuese në fushën e shëndetësisë, etj). ⁴³	- Realizimi i veprimtarive me dhe për rininë në fusha të ndryshme (shëndet, arsim, sociale, mjedis, etj) ⁴⁴	NJQV ka realizuar një sërë fushatash ndërgjegjësimi si: dhuna, shëndeti seksual riprodhues, shëndeti mendor, me studentët e Universiteteve. ⁴⁵	- Nxitja e përfshirjes së të rinjve në aktivitete edukuese shëndetësore, si: (1) shëndeti seksual riprodhues, (2) krijimi dhe mbështetja e grupeve "edukatorë bashkëmohatarë" ("peer education groups"), (3) konkurse mes shkollave të mesme, (40) ngritja/përmirësimi i shërbimit shëndetësor	

³⁶Këto detyrime/ aktivitete/ tregues janë gjenëruar bazuar në ligjet përkatëse ose janë evidentuar nga ekspertët e hartimit të këtij dokumenti;

³⁷Të dhënat e prezantuara në këtë kolonë, janë bazuar në analizën "TË BUXHETOJMË PËR RININË ME RININË"; Bashkia e Durrës; Burimi: https://observer.org.al/wp-content/uploads/2018/12/Buxhetimi-per-rinine-Durres_12Dhjetor2018.doc.pdf

³⁸Të dhënat e prezantuara në këtë kolonë, janë bazuar në analizën "TË BUXHETOJMË PËR RININË ME RININË"; Bashkia e Durrës; Burimi: https://observer.org.al/wp-content/uploads/2018/12/Buxhetimi-per-rinine-Durres_12Dhjetor2018.doc.pdf

³⁹Ligji 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", Nenin 3: pikat d), dh) dhe f).

⁴⁰Diktuar nga ligji përkatës;

⁴¹Diktuar nga ligji përkatës;

⁴²TË BUXHETOJMË PËR RININË ME RININË"; Bashkia Durrës, Q.2, V.2.6, fq 12; Link: https://observer.org.al/wp-content/uploads/2018/12/Buxhetimi-per-rinine-Durres_12Dhjetor2018.doc.pdf

⁴³Ligji 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", Nenin 23;

⁴⁴Evidentuar nga ekspertët e hartimit të këtij dokumenti

⁴⁵TË BUXHETOJMË PËR RININË ME RININË"; Bashkia Durrës, fq 5; Link: https://observer.org.al/wp-content/uploads/2018/12/Buxhetimi-per-rinine-Durres_12Dhjetor2018.doc.pdf

3	Funksionet e bashkisë në fushën e shërbimeve sociale. ⁴⁷	- NJQV ndërmerr shërbime sociale targetuar rininë. ⁴⁸		për gratë, të rejat dhe vajzat në Manëz. ⁴⁹
4	Funksionet e bashkisë në fushën e kulturës, sportit dhe shërbimeve argëtuese. ⁴⁹	- NJQV bashkëorganizon me të rinjtë veprimtari në fushën e kulturës, sportit dhe shërbimeve argëtuese. ⁵⁰		Nxjtja e përfshirjes së të rinjve në aktivitete kulturore. ⁵¹
5	Funksionet e bashkisë në fushën e mbrojtjes së mjedisit. ⁵²	- NJQV bashkëorganizon me të rinjtë veprimtari në fushën e mbrojtjes së mjedisit, si: informim, ndërgjegjësim, edukim, apo qoftë dhe ngritjen e guidave dhe aktiviteteve publike, organizuar me të rinjtë për promovimin e turizmit lokal, pastrimin e mjedisit etj. ⁵³		Nxjtja e përfshirjes të rinjve në aktivitete mjedisore, si: (1) nxjtja e pjesëmarrjes aktive të të rejave dhe të rinjve në hartimin dhe monitorimin e politikave mjedisore dhe turistike në nivel lokal, (2) aktivitete pastrimi, pyllëzimi apo riciklimi, (3) aktivitete sensibilizuese mbi mjedisin. ⁵⁴
6	Funksionet e bashkisë në fushën e zhvillimit ekonomik vendor. ⁵⁵	- NJQV ndërmerr nisma për fuqizimin ekonomik të të rinjve, si: realizimi i kurseve të ndryshme të zhvillimit profesional, bashkëpunimi me donatorë apo Organizata, etj. ⁵⁶	NJQV ka realizuar seanca informuese nxitjen e punësimit të të rinjve dhe rejave me aftësi të kufizuar. ⁵⁷	- Organizimi i takimeve sensibilizuese dhe aktiviteteve që nxisin vetëpunësimin e të rinjve. ⁵⁸
7	Funksionet e bashkisë në fushën e sigurisë publike. ⁵⁹	- NJQV ndërmerr nisma të gërshtuara dhe me institucionet e		

⁴⁶TË BUXHETOJMË PËR RININË ME RININË; Bashkia Durrës, Q 5, V 5.1-V 5.4, fq 13;

Link: https://observator.org.al/wp-content/uploads/2018/12/Buxhetimi-per-rinine-Durres_12Dhjetor2018.doc.pdf

⁴⁷Ligji 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", Nenin 24;

⁴⁸Evidentuar nga ekspertët e hartimit të këtij dokumenti;

⁴⁹Ligji 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", Nenin 25;

⁵⁰Evidentuar nga ekspertët e hartimit të këtij dokumenti;

⁵¹TË BUXHETOJMË PËR RININË ME RININË; Bashkia Durrës, q 4, V 4.1-V 4.3, fq 13;

Link: https://observator.org.al/wp-content/uploads/2018/12/Buxhetimi-per-rinine-Durres_12Dhjetor2018.doc.pdf

⁵²Ligji 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", Nenin 26;

⁵³Evidentuar nga ekspertët e hartimit të këtij dokumenti;

⁵⁴TË BUXHETOJMË PËR RININË ME RININË; Bashkia Durrës, q 3, V 3.1-V 3.3, fq 12;

Link: https://observator.org.al/wp-content/uploads/2018/12/Buxhetimi-per-rinine-Durres_12Dhjetor2018.doc.pdf

⁵⁵Ligji 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", Nenin 28;

⁵⁶Evidentuar nga ekspertët e hartimit të këtij dokumenti;

⁵⁷TË BUXHETOJMË PËR RININË ME RININË; Bashkia Durrës,

fq 6; Link: https://observator.org.al/wp-content/uploads/2018/12/Buxhetimi-per-rinine-Durres_12Dhjetor2018.doc.pdf

⁵⁸TË BUXHETOJMË PËR RININË ME RININË; Bashkia Durrës, Q 2, V 2.2 – V 2.3, fq 11;

Link: https://observator.org.al/wp-content/uploads/2018/12/Buxhetimi-per-rinine-Durres_12Dhjetor2018.doc.pdf

⁵⁹Ligji 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", Nenin 29;

Ligji për financat e vetëqeverisjes		tjera lokale për çështje të sigurisë publike; ⁶⁰		
8	Detyrimi për konsultime publike nga Njësitë e vetëqeverisjes vendore (NJQV). ⁶¹	NJQV organizon minimalisht 1 seancë konsultimi publik në (1) vit, me grupet e ndryshme të interesit që jetojnë në territorin e Bashkisë. ⁶²	Këshilli Bashkiak ka zhvilluar seanca dëgjimore dedikuar çështjeve të rinisë. ⁶³	
1	Kryetari i NJQV organizon seanca dëgjimore me komunitetin dhe grupet e interesit për projekt dokumentin e Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA) të rishikuar. ⁶⁴	NJQV mund dhe duhet të mbështetin iniciativat të buxhetuara për rininë në linjë me nevojat e tyre. ⁶⁵	Buxheti i Bashkisë dedikuar direkt ose indirekt rinisë është pjesë e programeve të Arsimit, Kulturës dhe Sportit. ⁶⁶	
1	NJQV bashkëpunon me Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MASR) për politikat, projektet e programet në fushën e rinisë. ⁶⁷	NJQV harton plan strategjik për programe në fushën e rinisë. ⁶⁸	Nuk Ë një plan sektorial për Rininë, por Ë një plan Veprimi për Barazinë Gjimore, ku janë parashikuar dhe prioritetet e rinisë. - Nuk Ë një plan sektorial për kujdesin shëndetësor. - Nuk Ë një plan sektorial për shërbimet sociale.	
2	NJQV kontribojnë në ofrimin e veprimtarive për të rinjtë në bashkëpunim me MASR, institucione dhe autoritete të tjera vendore, duke përcaktuar	NJQV harton standartet për ofrimin e veprimtarive rinore dhe punësimit të rinjve. ⁷¹		- Vlerësimi i kërkesës së tregut të punës. ⁷²

⁶⁰ Evidentuar nga ekspertët e hartimit të këtij dokumenti;

⁶¹ Ligji 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", Nenin 16;

⁶² Diktuar nga ligji përkatës;

⁶³ "TË BUXHETOJMË PËR RININË ME RININË"; Bashkia Durrës, fq 7;

Link: https://observator.org.al/wp-content/uploads/2018/12/Buxhetimi-per-rinine-Durres_12Dhjetor2018.doc.pdf

⁶⁴ Ligji 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", Nenin 38, pika 2;

⁶⁵ Diktuar nga ligji përkatës;

⁶⁶ "TË BUXHETOJMË PËR RININË ME RININË"; Bashkia Durrës, fq 6;

Link: https://observator.org.al/wp-content/uploads/2018/12/Buxhetimi-per-rinine-Durres_12Dhjetor2018.doc.pdf

⁶⁷ Ligji 75/2019 "Për rininë", Neni 5;

⁶⁸ Diktuar nga ligji përkatës;

⁶⁹ "TË BUXHETOJMË PËR RININË ME RININË"; Bashkia Durrës, fq 5;

Link: https://observator.org.al/wp-content/uploads/2018/12/Buxhetimi-per-rinine-Durres_12Dhjetor2018.doc.pdf

⁷¹ Diktuar nga ligji përkatës;

⁷² TË BUXHETOJMË PËR RININË ME RININË"; Bashkia Durrës, Q 2, V 2.1, fq 11;

Link: https://observator.org.al/wp-content/uploads/2018/12/Buxhetimi-per-rinine-Durres_12Dhjetor2018.doc.pdf

	standardet në ofrimin e veprimtarive rinore dhe punës me rininë. ⁷⁰				
3	NJQV në përputhje me funksionet e tyre, hartojnë dhe zbatojnë politikat vendore në fushën e rinisë. ⁷¹	Përcakton objektiva dhe prioritetet për të siguruar zbatimin e të drejtave të të rinjve. ⁷⁴			
3.1		KVR si organ këshillimor, funksionon pranë kryetarit të Bashkisë. KVR kryesohet nga kryetari dhe ka minimalisht 4-6 të rinj anëtarë. Kriteret, procedurat e përzgjedhjes së anëtarëve të KVR, si dhe mënyra e organizimit dhe funksionimit të tij miratohen me vendim të Këshillit Bashkiak. ⁷⁵	- Ë Këshilli Rinor pranë Bashkisë (Viti 2015)	Riaktivizimi i Këshillit Rinor duke respektuar balancën gjinore si dhe përfaqësimin e të rejave dhe të rinjve nga grupe të pafavorizuara (persona me aftësi të kufizuara, minoriteti Rom, Egjiptjan, komuniteti LGBTI, etj); nxitjes së pjesëmarrjes aktive të tij në proceset vendimmarrëse të Bashkisë. ⁷⁶	KVR këshillon NJQV për drejtimin e politikave dhe planeve vendore për rininë. - KVR vlerëson situatën dhe zbatimin e planeve dhe politikave rinore në nivel vendor. - KVR propozon përmirësime të politikave vendore, si dhe nisat për nevojat e të rinjve në territorin ku veprojnë. - KVR bashkëpunon dhe shkëmben informacion me Këshillin Kombëtar të Rinisë (KKR).
3.2		Organizimi dhe koordinimi i veprimtarive për fuqizimin dhe mbrojtjen e të rinjve. ⁷⁷	- NJQV nuk ka një specialist të dedikuar për rininë. ⁷⁸	- Aktivitetet sensibilizuese me qëllim zvogëlimin e stereotipeve/ diskriminimit gjinor dhe përfshirjen e të rejave dhe të rinjve në proceset vendimmarrëse dhe jetën publike. ⁷⁹ - Mbështetja me bursa e të rejave dhe të rinjve nga familje në nevojë, për	

⁷⁰ Ligji 75/2019 "Për rininë", Neni 5;

⁷¹ Ligji 75/2019 "Për rininë", Neni 7;

⁷⁴ Diktuar nga ligji përkatës;

⁷⁵ Ligji 75/2019 "Për rininë", Neni 10;

⁷⁶ TË BUXHETOJMË PËR RININË ME RININË; Bashkia Durrës, Q 1, V 1.1 – V 1.5, fq 9;

Link: https://observator.org.al/wp-content/uploads/2018/12/Buxhetimi-per-rinine-Durres_12Dhjetor2018.doc.pdf

⁷⁷ Diktuar nga ligji përkatës;

⁷⁸ TË BUXHETOJMË PËR RININË ME RININË; Bashkia Durrës, fq 6;

Link: https://observator.org.al/wp-content/uploads/2018/12/Buxhetimi-per-rinine-Durres_12Dhjetor2018.doc.pdf

⁷⁹ TË BUXHETOJMË PËR RININË ME RININË; Bashkia Durrës, Q 1, V 1.2 – V 1.6, fq 10;

Link: https://observator.org.al/wp-content/uploads/2018/12/Buxhetimi-per-rinine-Durres_12Dhjetor2018.doc.pdf

			kryerjen e shkollave të formimit profesional në qytetin e Durrësit. ⁸⁰
3.3	Organizimin dhe ofrimin e veprimtarive për të mbështetur mirëqenien dhe zhvillimin e të rinjve. ⁸¹	NJQV ka realizuar aktivitete të ndryshme në bashkëpunim me organizata të ndryshme.	
3.4	Nxhtjen e vullnetarizimit të të rinjve dhe edukimin joformal të tyre. ⁸²	NJQV ka realizuar aktivitete informuese dhe ndërgjegjësuese me të rinjtë e Universiteteve. ⁸³	
3.5	Financimin e krijimit dhe të zhvillimit të infrastrukturës rinore dhe të hapësirave rinore të sigurta - si Qendra rinore. ⁸⁴	Nuk ka qendër rinore, por ka një qendër shumë-funksionale. - ∃ dy Organizata lokale për rininë: Civil Society Development Center (CSDC) dhe "Zëri 16+".	
3.6	Krijimin e strukturave administrative për çështjet e rinisë, si pjesë e NJQV. ⁸⁵	∃ Punonjësi specialist i shëndetit, i cili është i njëjti me punonjësin e Njësisë për Mbrojtjen e Fëmijëve në Bashki. ⁸⁶	
3.7	NJQV mbledh, analizon dhe raporton për situatën e të drejtave të të rinjve. ⁸⁷	NJQV nuk disponon të dhëna në lidhje me grupmoshën rinore 15-29 vjeç, banor të Bashkisë Durrëse. ⁸⁸ - Nuk ka bërë ndonjë vlerësim për të	

⁸⁰ "TË BUXHETOJMË PËR RININË ME RININË", Bashkia Durrës,

Link: https://observator.org.al/wp-content/uploads/2018/12/Buxhetimi-per-rinine-Durres_12Dhjetor2018.doc.pdf

⁸¹ Diktuar nga ligji përkatës;

⁸² Diktuar nga ligji përkatës;

⁸³ "TË BUXHETOJMË PËR RININË ME RININË", Bashkia Durrës, fq 6;

Link: https://observator.org.al/wp-content/uploads/2018/12/Buxhetimi-per-rinine-Durres_12Dhjetor2018.doc.pdf

⁸⁴ Diktuar nga ligji përkatës;

⁸⁵ Diktuar nga ligji përkatës;

⁸⁶ "TË BUXHETOJMË PËR RININË ME RININË", Bashkia Durrës, fq 6;

Link: https://observator.org.al/wp-content/uploads/2018/12/Buxhetimi-per-rinine-Durres_12Dhjetor2018.doc.pdf

⁸⁷ Diktuar nga ligji përkatës;

⁸⁸ "TË BUXHETOJMË PËR RININË ME RININË", Bashkia Durrës, fq 5;

Link: https://observator.org.al/wp-content/uploads/2018/12/Buxhetimi-per-rinine-Durres_12Dhjetor2018.doc.pdf

			identifikuar nevojat dhe prioritetet e të rinjve. ⁸⁹	
4	NJQV aplikon për t'u mbështetur nga programet kombëtare dhe ndërkombëtare për rininë, në përputhje me këtë ligj dhe aktet nënligjore në fuqi. ⁹⁰	Numri i aplikimeve të realizuara dhe të fituara nga NJQV me fokus ose përfshirë tematikën rinore. ⁹¹		
5	NJQV bashkëpunon me institucione të tjera vendore nëpërmjet lidhjes së marrëveshjeve të përbashkëta, në përputhje me legjislacionin në fuqi për vetëqeverisjen vendore. ⁹²	- Numri i marrëveshjeve të realizuara me fokus ose përfshirë tematikën rinore. ⁹³ - Bashkëpunime të NJQV me institucione të tjera vendore. ⁹⁴	Marrëveshje me Observatorin (2019-2021)	
6	NJQV bashkëpunon me organizatat për rinjtë e organizatat rinore shqiptare në diasporë, për të mbajtur komunikimin me të rinjtë shqiptarë të Bashkisë, që janë larguar nga Bashkia apo vendi. ⁹⁵	Numri i bashkëpunimeve apo aktiviteteve të tilla të realizuara. ⁹⁶		
1	OZHQ/SDG – Nxitja e përfshirjes së të rinjve në aktivitete për arritjen e OZHQ/SDG.	NJQV bashkërendon politikat dhe nismat me dhe për rininë në gërrshetim me OZHQ/SDG. ⁹⁷		- Aktivitete informuese mbi OZHQ/SDG ⁹⁸ - Iniciativa "Rinia Durrsake për OZHQ/SDG" ⁹⁹ - Panairi i ideve "Dita botërore të aftësive të të rejave të rinjve" ¹⁰⁰

⁸⁹TË BUXHETOJMË PËR RININË ME RININË", Bashkia Durrës, fq 7;

Link: https://observator.org.al/wp-content/uploads/2018/12/Buxhetimi-per-rinine-Durres_12Dhjetor2018.doc.pdf

⁹⁰Ligji 75/2019 "Për rininë", Neni 7;

⁹¹Diktuar nga ligji përkatës;

⁹²Ligji 75/2019 "Për rininë", Neni 7;

⁹³Diktuar nga ligji përkatës;

⁹⁴Evidentuar nga ekspertët e hartimit të këtij dokumenti;

⁹⁵Ligji 75/2019 "Për rininë", Neni 7;

⁹⁶Diktuar nga ligji përkatës;

⁹⁷Evidentuar nga ekspertët e hartimit të këtij dokumenti;

⁹⁸TË BUXHETOJMË PËR RININË ME RININË", Bashkia Durrës, fq 14;

Link: https://observator.org.al/wp-content/uploads/2018/12/Buxhetimi-per-rinine-Durres_12Dhjetor2018.doc.pdf

⁹⁹Ibid;

¹⁰⁰Ibid;

LISTA E SHKURTIMEVE

E	Ekziston
BE	Bashkimi Evropian
KKR	Këshillin Kombëtar të Rinisë
KVR	Këshilli Vendor i Rinisë
NJQV	Njësia e Qeverisjes Vendore
OZHQ / SDG	Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm/ Sustainable Development Goals (Eng)
YAC	Youth Advisory Council

